



**Republika e Kosovës – Republika Kosovo– Republic of Kosova
Kuvendi – Skupština – Assembly**

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË
19 SHKURT 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
19. FEBRUARA 2008. GODINE**

**Shkurt – Februar
2008**

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 19 SHKURT 2008

Seanca filloi punën në orën 15,00.

Seancën e drejtoi, zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT: I nderuari Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Sot, më 19 shkurt 2008, po e mbajmë seancën e parë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kuvendit i dëshiroj punë të mbarë në bërjen e ligjeve të Republikës së Kosovës!

Deputetëve dhe deputeteve u dëshiroj shëndet të mirë, sukses në punë e jetë!

Suksese, shëndet, begati e mbarësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës!

Shfrytëzoj rastin që, në emrin tuaj dhe timin, t'i falënderoj të gjithë shqiptarët, të gjitha minoritetet, të gjithë qytetarët tanë, brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, për manifestime dinjitoze që organizuan për Ditën e Pavarësisë e të sovranitetit të shtetit tonë.

Një falënderim të veçantë të gjitha mediave vendore e ndërkombëtare për informim korrekt që i bënë opinionit vendor e ndërkombëtar.

Gjithashtu, shfrytëzoj rastin për t'i përshëndetur edhe qytetarët serbë të Republikës së Kosovës që nuk u ndien mirë në rastin e pavarësisë e të sovranitetit të Republikës së Kosovës, ndonëse ky akt sublim nuk është i drejtuar dhe as që i dëmton interesat e akëcilil komunitet në Republikën e Kosovës. Është e drejtë kushtetuese e qytetarëve për të protestuar, ndonëse nuk kanë arsye, pasi me Kushtetutë e me ligje do të mbrohen liria individuale e kombëtare, të drejtat e njeriut dhe e drejta e pronës, e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës në çdo cep të saj. Këto dhe shumëçka tjetër janë thënë dhe garantohen në mënyrë të qartë në Deklaratën e Pavarësisë, janë thënë qartë në dokumentin gjithëpërfshirës të Presidentit Ahtisari. Thuhet qartë dhe është sanksionuar edhe në Projektkushtetutën e Republikës së Kosovës, që është përgatitur dhe pritët të miratohet së shpejti në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Një mirënjohje të veçantë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Presidentin Bush, për Bashkimin Evropian, për Francën dhe Presidentin Sarkozy, për Britaninë e Madhe dhe Kryeministrin Braun, për Belgjikën, Izraelin, Turqinë, Shqipërinë, Afganistanin dhe të gjitha vendet e tjera që e njohën pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, mirënjohje edhe për Gjermaninë, Italinë dhe të gjitha vendet e tjera që e mirëkuptuan dhe po përgatiten ta njohin shtetin tonë të ri.

Ne jemi të bindur se përshpejtimi për njohjen e shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, nga të gjitha vendet e Bashkimit Evropian dhe nga të gjithë anëtarët e OKB-së, i ka dy anë pozitive. Prandaj, nuk duhet hezituar për dy arsye, sepse:

1. Njohja e përmbyll një proces të natyrshëm, e korrigjon një padrejtësi historike, perspektivës i hap të gjitha rrugët e zhvillimit demokratik dhe ekonomik.

Njohja e Republikës së Kosovës nuk krijon rast precedent. Është rast i veçantë, pasi Kosova në Evropë ishte rast i veçantë që nga viti 1912 dhe 1913, ishte rast i veçantë gjatë gjithë dekadave të pasluftës së Dytë Botërore dhe gjatë këtyre dhjetë vjetëve të administrimit ndërkombëtar të Kosovës.

2. E ndihmon politikën serbe që të shkëputet nga e kaluara jodemokratike dhe do të përshpejtojë në Serbi sundimin e demokracisë dhe të partneritetit reciprok. Përshpejton procesin e integrimi demokratike në harmoni me të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

Apelojmë te të gjitha vendet e OKB-së që të përshpejtojnë procesin e njohjes së shtetit të 193-të, shtetit të Kosovës në Asamblenë Kombëtare të Shteteve të Pavarura.

Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,

I nderuari Kryeministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 109 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të vazhduar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuar në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë të datës 15 shkurt 2008, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Rendi i ditës, së bashku me materialin, iu është shpërndarë deputetëve.

Rendi i propozuar i ditës është:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme;
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për privilegje dhe imunitete diplomatike;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shtetësinë;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për policinë;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin policor;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore;
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat e veçanta të mbrojtura;
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vetëqeverisjen lokale, dhe
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kufijtë administrativë të komunave.

A pajtoheni me këtë rend të ditës?

Kush është “për”? Faleminderit!

A ka ndokush “kundër”? Një është “kundër”. Faleminderit!

Konstatoj se me shumicë absolute të votave “për” dhe me 1 “kundër”, miratohet rendi i ditës.

Atëherë, fillojmë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin i tij, në parim, konform vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj Kryeministrin e Kosovës që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari zoti Kryetar, deputetë, kolegë, ministra, Është dita e dytë e vazhdimit të përkushtimeve institucionale të Kosovës për implementimin e dokumentit gjithëpërfshirës për Kosovën e pavarur, sovranë dhe demokratike. Qeveria e Kosovës, menjëherë, qysh dje, ka prezantuar një sërë projektligjesh për Kuvendin. Prandaj, sot kam kënaqësinë që, para jush, të paraqes edhe personalisht Projektligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme, i hartuar nga Zyra e Kryeministrit.

Në këto momente historike të themelimit të shtetit të Kosovës, Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme themelon një institucion dhe autoritet të ri të Republikës së Kosovës për realizimin e punëve të jashtme, promovimin ndërkombëtar të interesave politike dhe ekonomike të Kosovës, si dhe zhvillimin e marrëdhënieve të mira me shtetet tjera.

Ky projektligj, është risi në vete dhe i domosdoshëm për rregullimin e kësaj sfere kaq të rëndësishme, sepse rregullon autoritetin dhe kompetencat e institucioneve të Kosovës lidhur me punët e jashtme dhe mbështet interesat politike dhe ekonomike të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Në fund kam nderin që pata rastin t'ju informoj në pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji kaq të rëndësishëm për vendin tonë dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet të rregullohen në suaza të kornizës ligjore adekuate.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

A po vazhdojmë konform vendimit që ka marrë seanca, më 15 shkurt, që të lexohen të gjitha ligjet në pako dhe në fund, grupet parlamentare të shprehin mendimet e tyre.

A pajtoheni ?

Kush është “për”? Faleminderit!

A ka kush “kundër”? Një është “kundër”.

Konstatohet se me shumicë absolute të votave, u miratua propozimi i paraqitur.

Pika e dytë:

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për privilegje dhe imunitete diplomatike

Zoti Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:

I nderuar, zoti Kryetar, deputetë, ministra, faleminderit!

Unë do të paraqes ekspozenë për Projektligjin për statusin, imunitetet dhe privilegjet e misionëve diplomatike dhe konsullore.

Një prej ligjeve prioritare, i cili duhet të kalojë gjatë periudhës së paraparë transitorë në Kosovë është edhe Projektligji për statusin, imunitetet dhe privilegjet e misionëve diplomatike dhe konsullore, personelin e tyre në Kosovë, praninë e tyre ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e tyre.

Ky projektligj rregullon dhe qartëson statusin, imunitetet, privilegjet e misionëve diplomatike dhe konsullore, duke përfshirë misionet e organizatave ndërkombëtare, ndërqeveritare, si dhe personelin e tyre në Kosovë – së bashku me personat e tjerë ndërkombëtarë të mbrojtur në përputhje me ligjin ndërkombëtar, siç është paraparë edhe në: Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplommatike, të datës 18 prill 1961; Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, të datës 14 prill 1963; Konventën e Përgjithshme për Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara, të datës 13 shkurt 1946 dhe Konventën për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjencive të Specializuara të Kombeve të Bashkuara, të datës 21 nëntor 1947, me qëllimin për të siguruar marrëveshjet kalimtare për misionet ekzistuese ndërlidhëse në Kosovë.

Përgatitjet për nxjerrjen e këtij projektligji parashihen edhe me Propozimin gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Në fund kërkoj që edhe ky projektligj të miratohet, në mënyrë që edhe këto çështje, të përcaktuara me këtë projektligj, sa më shpejt të kenë rregullimin e tyre adekuat ligjor.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Pika e tretë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shtetësinë

Projektligji u është shpërndarë deputetëve, më 18 shkurt 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008. Ftoj ministrin Zenun Pajaziti, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: I nderuar zoti Kryetar,

Zoti Kryeministër dhe ministra

Të nderuar deputetë.

Aktualisht Kosova nuk e ka të rregulluar me dispozita ligjore mënyrën dhe kushtet e fitimit të shtetësisë. Fushëveprimi i këtij projektligji është të përcaktojë mënyrat e fitimit dhe humbjes së shtetësisë së Kosovës, si dhe rregullimin e çështjeve të tjera të ndërlidhura me shtetësinë. Qëllimi kryesor i këtij projektligji është që në mënyrë unike t'i përcaktojë rregullat ligjore lidhur me fitimin dhe humbjen e shtetësisë së Kosovës, kompetencat dhe mënyrat e mbajtjes së regjistrit të shtetasve, si dhe mënyrën e dëshmimit të shtetësisë, statusin e banorëve të përhershëm të Kosovës dhe fitimin e shtetësisë sipas dokumentit për statusin e Kosovës.

Projektligji ka 6 kapituj me gjithsej 32 nene. Projektligji krijon stabilitet në fushën e shtetësisë, të cilën e rregullon. Për implementimin e këtij ligji nuk kërkohen mjete buxhetore shtesë. Ky ligj krijon të hyra që priten të realizohen nga taksat administrative për dhënien edhe humbjen e shtetësisë.

Projektligji ka marrë deklaratën e pajtueshmërisë nga Agjencia për Integritet Evropian, që do të thotë është në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e BE-së. Nga arsyet e theksuar, propozoj që Kuvendi i Kosovës ta miratojë këtë projektligj.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për policinë

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj ministrin Zenun Pajazitin që në emër të Qeverisë, para deputetëve, të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Më lejoni të vazhdoj , po ashtu, edhe për Projektligjin për policinë e Republikës së Kosovës, ta bëj prezantimin.

Hartimi i Projektligjit për policinë e Kosovës ka filluar që nga muaji qershor të vitit 2006. Në hartimin e këtij drafti kanë qenë të përfshirë disa organizata joqeveritare, agjencitë e ndryshme, misionet ndërkombëtare në Kosovë e tjerë.

Fushëveprimi i këtij projektligji është themelimi i policisë së Kosovës, përshkrimi i autorizimeve dhe detyrave të saj dhe i zyrtarëve policorë, organizimi i brendshëm i policisë dhe sqaron çështje të tjera që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe veprimet e policisë së Kosovës.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është me rëndësi të madhe, sepse Kosova nuk i ka të rregulluara me ligj çështjen e themelimit të policisë, autorizimet, strukturën organizative, veprimtarinë e saj e cila, pjesërisht, deri më tani është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/54.

Qëllimi për hartimin e këtij projektligji është vendosja e rregullave ligjore për rregullimin e veprimtarive të policisë Republikës së Kosovës, përfshirë organizimin, detyrat dhe autorizimet.

Projektligji ka 8 kapituj me 75 nene. Projektligji krijon stabilitet legjislativ në fushën në të cilën e rregullon.

Projektligji për policinë ka implikime buxhetore që vlerësohet të jenë, përafërsisht, prej 33 milion euro për periudhën prej vitit 2008 – 2010.

Projektligji ka deklaratën e pajtueshmërisë së Agjencisë për Integritet Evropian, që nënkupton se është në pajtim me legjislacionin e BE-së.

Nga këto arsye, propozoj, po ashtu, që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë edhe këtë projektligj.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!
Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin Policor

Projektligji është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008. Ftoj ministrin Zenun Pajaziti që në emër të Qeverisë, para deputetëve, ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ZENUN PAJAZITI: Faleminderit zoti Kryetar!

Në shtetin e së drejtës, të cilën po e synojmë ta ndërtojmë, autoritetet publike autorizimet e tyre ushtrojnë brenda kufijve që ia përcakton ligji. Në këtë kontekst edhe veprimtaria e Inspektoratit të Policisë së Kosovës, si organ publik në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që e mbikëqyr punën e Policisë së Kosovës është rregulluar me dispozitat e ligjit për të cilën po e paraqes këtë ekspozë.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është që në mënyrë unike të vendosë rregulla ligjore lidhur me organizimin, funksionet dhe autorizimet e Inspektoratit të Policisë së Kosovës.

Nevoja për nxjerrjen e projektligjit në fjalë është një rëndësi e madhe, ngase kemi të bëjmë me një fushë e cila aktualisht është rregulluar, pjesërisht, me Rregulloren e UNMIK-ut- 2005/54 dhe Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2006/9.

Projektligji adreson të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me themelimin dhe strukturën organizative të Inspektoratit të Policisë së Kosovës, detyrat dhe autorizimet e tij, parimet udhëheqëse, marrëdhëniet e punës dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe veprimet e Inspektoratit të Policisë së Kosovës.

Projektligji është bazuar në modelet më të avancuara që rregullojnë këtë fushë, me theks të veçantë me atë të Britanisë së Madhe dhe është në harmoni me normat dhe standardet më të larta të Bashkimit Evropian.

Projektligji ka 12 kapituj me gjithsej 36 nene.

Projektligji krijon stabilitet legjislativ për fushën të cilën e rregullon dhe për zbatimin e tij nevojiten mjete buxhetore shtesë.

Projektligji ka marrë deklaratën e pajtueshmërisë të Agjencisë për Integritet, që do të thotë është në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e BE-së.

Po ashtu, i propozoj Kuvendin që ta miratojë Projektligjin për Inspektoratin e Policisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Zoti ministër!

Tani kemi në shqyrtim pikën e gjashtë.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dokumentet e udhëtimit

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj ministrin Zenun Pajaziti, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë edhe këtë projektligj.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nevoja për nxjerrjen e këtij ligji tani më dihet, sidomos në periudhën të cilën kemi hyrë pas shpalljes së pavarësisë, është me interes të veçantë për Kosovës dhe qytetarët e saj. Përmes dokumenteve të udhëtimit, qytetarëve të Kosovës u mundësohet lëvizja e lirë në shtetet e tjera, pra kalimi i kufirit shtetëror.

Projektligji është përgatitur duke pas parasysh rrethanat dhe kërkesat e reja në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe, qytetarët e Kosovës janë pajisur vetëm me një lloj dokumenti të udhëtimit, pasaportat e lëshuara nga UNMIK-u, ndërsa me këtë ligj shtetasit e Republikës së Kosovës do të pajisen me dokumentet e udhëtimit të parapara në neni 7 të këtij projektligji, ndër këto, edhe me pasaporta diplomatike dhe pasaporta zyrtare për stafin udhëheqës të institucioneve kryesore të Republikës së Kosovës dhe stafin diplomatik e politik, që do të lëshohen nga Ministria e Punëve të Jashtme, e cila do të themelohet së shpejti.

Çështja tjetër me rëndësi është se dokumentet e udhëtimit do të përmbajnë edhe stemën e Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj përcaktohen procedurat dhe mënyra e aplikimit për dhënien e dokumenteve të udhëtimit, llojet dhe vlefshmëria e dokumenteve të udhëtimit për shtetasit e Kosovës, si dhe gjobat për shtetasit që nuk u përmbahen dispozitave të këtij ligji.

Me këtë ligj eliminohen zbrazëtirat ligjore që kanë të bëjnë me pajisjet e qytetarëve të Kosovës me dokumentet e udhëtimit.

Qëllimi i Projektligjit është t'i përcaktoj rregullat lidhur me kërkesat e qytetarëve për të pajisur me dokumentet e udhëtimit, refuzimi për dhënien e dokumenteve nga organi kompetent dhe vlefshmëria e tyre.

Projektligji ka 9 kapituj me 40 nene.

Nga arsyet e theksuara propozoj që Kuvendi, po ashtu, ta miratojë edhe këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë,

Kryeministri dhe dy zëvendëskryeministrat, për arsye të takimit me zotin Solana dhe Piter Feith, kthehen menjëherë. Mund të shkoni.

Kështu që është mirë edhe të tjerët me marrë mësim nga Kryeministri dhe zëvendëskryeministrat që pa leje të mos shkojnë.

Pika e shtatë e rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorimin e simboleve shtetërore

Projektligji është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe janë përmbytur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj ministrin Arsim Bajrami, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ju demonstruat se çka është kontrolli Parlamentar i Qeverisë, me vetë faktin se i dhatë leje Kryeministrit të abstenojë nga seanca.

I nderuari, zoti Kryetar,
Të nderuar deputetë.

Përdorimi i simboleve shtetërore në Republikën e Kosovës është një fushë e pambuluar deri më tani me dispozitat ligjore. Arsyeja e hartimit të këtij projektligji është rregullimi me ligj i përdorimit të simboleve shtetërore në Republikën e Kosovës.

Duke pasur parasysh këtë që u tha më lartë, shtrojmë para jush për miratim Projektligjin për simbolet shtetërore, i cili është miratuar nga Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt të vitit 2008.

Vetë projektligji është risi ngase për herë të parë pretendohet rregullimi ligjor në mënyrë gjithëpërfshirëse i fushës së përdorimit të simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjet dhe standardet evropiane.

Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregullat për përdorimin e simboleve shtetërore të detyrueshme për të zbatuar nga institucionet qendrore dhe lokale dhe nga qytetarët e Kosovës.

Çështjet themelore që adreson ky projektligj janë: Përcaktimi i normave për përdorimin e simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës, përdorimi i flamurit, stemës dhe himnit, mënyrës dhe radhitjes të simboleve shtetërore, përcaktimi i normave për vendosjen e flamurit, stemës dhe për intonimin e himnit.

Projektligji përbëhet prej 5 pjesëve dhe ka gjithsej 19 nene.

Miratimi i këtij projektligji përbën një hap përpara në rregullimin me ligj të përdorimit të simboleve shtetërore në Republikën e Kosovës.

Andaj, i nderuari zoti Kryetar, të nderuar deputetë, ju sugjerojmë ta miratoni këtë projektligj.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Në radhë është pika e tetë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat e veçanta të mbrojtura

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj ministrin Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryetar,

E nderuara Kryesi,

Të nderuar deputetë.

Kam kënaqësinë që para jush të paraqes Projektligjin për themelimin e zonave të veçanta të mbrojtura. Baza ligjore për nxjerrjen e këtij projektligji është obligim që del nga Pakoja e Ahtisarit, aneksi 5, i cili ka të bëjë me trashëgiminë fetare dhe kulturore, ku parashihet themelimi i zonave të veçanta të mbrojtura.

Ky ligj është në përputhje me konventën e UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të botës, e miratuar në Paris në vitin 1972 me të cilën secili shtet garanton mbrojtjen e kësaj trashëgimie.

Po ashtu, edhe ligji i Kuvendit të Kosovës për trashëgiminë kulturore parasheh që çdo person juridik dhe fizik ka për detyrë të kujdeset për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të vendit.

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i këtij projektligji është që të bëhet sigurimi i ekzistimit dhe funksionimit paqësor të objekteve dhe tërësive të mbrojtura, ruajtja e karakterit dhe e pamjes së vendeve që do të mbrohen, në veçanti, kontesti historik, kulturor, arkeologjik dhe kuadri vizionar, si dhe parandalimi i zhvillimit negativ për rreth tyre, duke siguruar kështu kushte më të mira të

mundshme për zhvillimin harmonik dhe të qëndrueshëm të banorëve të cilët banojnë në hapësira për rreth këtyre objekteve.

Sa i përket përmbajtjes të Projektligjit për themelimin e zonave të veçanta të mbrojtura , ai përfshin një numër të manastireve ortodokse serbe, kishave vende religjioze historike dhe kulturore të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb të Kosovës, si dhe komunitetet e tjera në Kosovë për t'u dhënë atyre mbrojtjen e veçantë që kërkohet.

Të nderuar deputetë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjithashtu, do të sigurojë që gjatë hartimit të planeve hapësinore për sipërfaqet brenda zonave të veçanta, të mbrojtura, të merren parasysh kufizimet e parapara nga ky projektligj.

Në fund, duke ju falënderuar për interesimin e treguar, ju përshëndes të gjithëve. Ju faleminderit! Teşekkür ederim!

KRYETARI: Ju faleminderit zoti Ministër!

Në radhë është pika e nëntë:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vetëqeverisjen lokale

Projektligji i u është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit të datës 15. shkurt 2008.

Ftoj ministrin Sadri Ferati, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

SADRI FERATI: Ju faleminderit!

I nderuari Kryetar,
Deputetë të nderuar,
Të nderuar ministra,

Ligji për vetëqeverisjen lokale ka për qëllim themelimin e një sistemi të funksionimit të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në territorin e Kosovës, në ofrimin e kushteve më të mira për të gjithë qytetarët e komunave dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve publike. Me këtë projektligj, në mënyrë të qartë sistematike dhe të bashkërenditur janë normuar statusi juridik i komunave, parimet e vetëqeverisjes lokale, kompetencat e komunave, organizimi dhe funksionimi i komunave, të drejta dhe detyrat e organeve komunale, parimet e financimit të komunave, bashkëpunimi ndërmjet komunave, demokracia lokale dhe marrëdhëniet e komunave me institucionet e nivelit qendror.

Projektligji ka marrë parasysh disa dokumente, përfshirë Kartën Evropiane për vetëqeverisje lokale, Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale apo të pakicave, Konventën për Bashkëpunimin

Ndërkufitar ndërmjet komuniteteve territorial ,prandaj propozojmë që Kuvendi ta miratojë këtë projektligj.

KRYETARI: Ju faleminderit zoti Ministër! Në radhë është pika e fundit e rendit të ditës

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kufijtë administrativ komunal

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 18 shkurt 2008. Janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim, konform vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008.

Ftoj Ministrin Sadri Ferati, që në emër të Qeverisë, para deputetëve ta prezantojë Projektligjin.

SADRI FERATI: Ju faleminderit!

I nderuari Kryetar,
Të nderuar deputetë,

Nevoja për këtë projektligj, është e një rëndësie të veçantë ngase kemi të bëjmë me një riorganizim territorial të komunave, respektivisht krijimin e pilot-njërive komunale dhe krijimin e komunave të reja, konform propozimit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës.

Hartimi i këtij projektligji ka lindur si nevojë e një riorganizimi të ri territorial, i cili do t'u ofronte shërbime më afër dhe më cilësore qytetarëve. Projektligji ka për qëllim që t'i adresojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me riorganizimin territorial të komunave, emrat e komunave, selitë e tyre, dispozitat tranzitore lidhur me komunat e reja, si dhe dispozitat kalimtare. Ky projektligj sjell risi në organizimin territorial, ngase në te përfshihen pilot-njësitë komunale dhe komunat e reja, të krijuara sipas Pakos së Ahtisarit. Sipas këtij projektligji Kosova do t'i ketë 38 komuna.

Gjatë hartimit të projektligjit, janë përdorur dhe konsultuar burimet e legjislacionit të shumë vendeve të rajonit, si dhe dokumenteve të Këshillit të Evropës, që e rregullojnë organizimin territorial të këtyre vendeve, duke pasur çdo herë parasysh specifikat, nëpër të cilat është duke kaluar Kosova.

Gjithashtu, me rastin e hartimit të këtij projektligji, janë konsultuar edhe ligjet e vendeve të rajonit që e rregullojnë këtë lëmi, respektivisht organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale të këtyre vendeve. Prandaj, i propozojmë Kuvendit që ta miratojë këtë projektligj.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Ministër!

Tani në radhë janë kryetarët e grupeve parlamentare. Sipas radhës, fjalën e ka Ramë Buja, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike.

RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë deputet,
Të respektuar ministra,

Dihet se koha ka qenë shumë e shkurtë për t'i përpunuar, por meqë ne si Grup Parlamentar i kemi ndarë detyrat në komisione të caktuara, sot në takimin që e kishim në orën 14,00, ne debatuam seriozisht për këto projektligje. Natyrisht, që ne në parim i përkrahim për tu shqyrtuar ose për t'u lexuar në leximin e dytë, por në fakt debat më i përmbajtjesor dhe më esencial u zhvillua për Projektligjin për zonat e veçanta të mbrojtura, për Projektligjin për vetëqeverisjen lokale dhe për Projektligjin për kufijtë administrativ komunal. Pra, u dakorduam që, për aq sa ka mundësi, deputetët e Grupit Parlamentar të PDK-së t'i bëjnë propozim amendamentet, për aq sa mund të futen në këto projektligje gjër në këtë kohë sa i kemi kufizuar, gjër nesër.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Sipas radhës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, shefi i Grupit, Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit zoti Kryetar,
Më lejoni, ju lutem, që të përshëndes edhe ministrat që janë të pranishëm,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke marrë parasysh obligimet që ky Parlament në mandatin e kaluar ka marrë kundrejt Propozimin gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari, duke marrë parasysh edhe mocionin tonë shumë efikas, të nënshkruar nga shefat e grupeve parlamentare dhe i miratuar, pothuajse njëzëri me 15 shkurt, veçanërisht marrë parasysh edhe Deklaratën për Pavarësinë e Kosovës, të miratuar me 17 shkurt, duke filluar nga pika 1 e më tej, që merr përsipër dhe zotohet për mbështetjen e ligjeve, projektligjeve që do të dalin nga Propozimi gjithëpërfshirës i ndërmjetësit Ahtisari, Grupi ynë, i Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbështetë parimisht këto ligje, këto projektligje, natyrisht, duke e ruajtur të drejtën që t'i thotë vërejtjet e veta eventuale.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në radhë është kryetari i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli.
Regjia ia jep fjalën kryetarit të AKR-së, Ibrahim Makolli

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, qëndrim do ta paraqesë zëvendëskryetarja e Grupit, zonja Rita Hajzeri.

RITA HAJZERAJ: Ju faleminderit!
Zoti Kryetar,
Të nderuar ministra dhe zëvendësministra,
Të nderuar kolegë deputetë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, i ka shqyrtuar projektligjet nga agjenda e sotme e këtij Kuvendi, përkundër sugjerimeve, vërejtjeve dhe propozimeve të caktuara për këtë etapë të procedurës, parimisht i mbështet, mirëpo sugjerimet dhe vërejtjet, gjithashtu, do t'i adresojmë te Komisioni Ad-hoc, i cili është formuar për këto projektligje.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, duke u bazuar në marrëveshjet që i kemi pasur paraprakisht, duke u bazuar në mocionin të cilin e kemi kaluar më me shumë se dy të tretat, i mbështet në parim, të gjitha ligjet, të cilat janë propozuar sot dhe në të njëjtën kohë njësor sikur grupet e tjera parlamentare do ta japë kontributin e vet në Komisionin Ad-hoc të krijuar për këto ligje.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në radhë është Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, zoti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë mbështet në parim miratimin e Pakos së ligjeve, që sot është proceduar në seancë plenare me shumë vërejtje të cilat mund t'i bëhet. Këto vërejtje, ne do t'i adresojmë edhe në komisionin përkatës. Mirëpo, është e rrugës, që gjatë leximit të parë të thuhet edhe dy- tri fjalë për të gjitha këto pako të ligjeve për shkak, jo veç traditës procedurale, por, është mirë, që ta kemi një informatë të përgjithshme.

Ajo çka mund të adresohet si vërejtje substanciale, që ka të bëjë me terminologjinë e cila është përdorur në një pjesë të madhe të këtyre ligjeve. Do të thotë nuk është adekuate dhe kjo terminologji, e cila është adresuar sot, mund të shkaktojë konfuzitet nesër. Prandaj ne, në formë të amendamenteve do t'i procedojmë në Komisionin Ad-hoc. Përpos asaj, duhet të caktohet edhe shumë statuti i shumë monumenteve. Do të thotë është shumë i paqartë dhe si vërejtje të përgjithshme, do ta adresojmë për vetë faktin se ka pasur shumë zhvillime, sidomos viteve të fundit, të cilat kanë shkaktuar konfuzitet. Mirëpo, ajo çka duhet të theksohet si vërejtje substanciale që duhet të kihet parasysh, është emërtimi i vendbanimeve. Ato, asnjëherë nuk do të duhej të ketë keqkuptim, për vet faktin se emërtimet të cilat janë përdorur në këto projekte, janë

emërtime të cilat nuk përkojnë as me realitetin ekzistues dhe nuk përkojnë aspak me terminologjinë apo edhe gjuhën që e përdorin në Kosovë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit zoti deputet!

Nga Grupi Parlamentar SLS, nuk ka.

Shkojmë nga Grupi Parlamentar 7+, në vend të Haxhi Merxhës, Enis Krvan

ENIS KRVAN: Sayın Başkan!

Sayın bakanlar, deyerli millet vekileri,

Kosova Cumuryetinin ilk meclis oturuma katılanlara kutlamak ve selamlamak istıyorum,

I nderuari Zoti Kryetar ,

Të nderuar ministra dhe deputetë!

Dëshiroj që ta përshëndes ketë Kuvend dhe t'ia uroj mbledhjen e parë si Kuvend i shtetit të posashpallur të Republikës së Kosovës.

Gëzimin për ketë e ndaj me ju dhe se në emër të Grupit Parlamentar “7 +”, ju informoj se grupi ynë parlamentar, në parim i përkrahë 10 projektligjet së bashku me propozimet e Komisionit Ad-hoc.

Krahas kësaj në emër të GP “7 +” mbaj shpresë që propozimet dhe sugjerimet tona që i kemi paraqitur dhe që do t'i paraqesim në Komisionin Ad-hoc, do të merren parasysh.
Ju faleminderit! Saygılar!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Sipas mocionit që e kemi votuar me 15 shkurt 2008, të drejtën e fjalës e kanë vetëm shefat e grupeve parlamentare.

Të nderuar deputetë,

Sipas marrëveshjes të 15 shkurtit 2008, sot në rend të ditës patëm 10 ligje dhe tani ne, duhet ta bëjmë miratimin në parim. Bëjmë miratimin, në parim, të projektligjeve, si vijon:

1. Projektligjin për Minisrine e Punëve të jashtme
2. Projektligjin për privilegje dhe imunitete diplomataike,
3. Projektligjin për shtetësinë,
4. Projektligjin për policinë
5. Projektligjiin për Inspektoratin policor,
6. Projektligjin për dokumentet e udhëtimit,
7. Projektligjin për përdorimin e simboleve të shtetit,
8. Projektligjin për zona të veçanta të mbrojtura,
9. Projektligjin për vetëqeverisjen lokale dhe
10. Projektligjin për kufijt dministrativ të komunave.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

A i keni të gjithë kartelat? Ju lutem keni votuar dhe nuk kem çka. Keni hyrë në fazën e votimit. A keni kartela të gjithë?

Kalojmë në votim. Lus regjinë le të përgatitet

Votojmë tani:

A ka ndokush që nuk ka kartela dhe dëshiron të votojë me dorë? (Një) Faleminderit! Do të thotë, konstatoj se me 84 votime “për”, 2 “kundër” dhe dy abstenime Kuvendi miratoi në parim projektligjet e përmendura.

Pas miratimit në parim, në bazë të vendimit të Kuvendit të datës 15 skurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës t’i paraqesë Kuvendit Raportin me rekomandime.

Seanca e ardhshme është nesër në orën 10,00, me propozim të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Mirëupafshim nesër, në orën 10.00.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës